~~~

5. LUTFI Nazif MAQEDONCIT, lind më 4. o2. 1962. në Prishtinë, student i Fakultetit teknik, me vendbanim të përhershëm në Prishtinë, rruga e Splitit nr. 20;

6. MARTIN Ndrec ÇUNI, lind më 14. o5. 1948. në fshatin Ujz, gazetar i Radio-Prishtinës, me vendbanim të përhershëm në Prishtinë, rruga e Bihaqit 20;

7. ARBAN Mehmet HOXHA, lind më 1. o9. 1963. në Prishtinë, nxënës i QAMO "9 Maj" në Prishtinë, me vendbanim të përhershëm në Prishtinë, rruga A.Gjorgjeviq nr. 11;

8. OSMAN Nazif MAQEDONCIT,lind më 2. o5. 1952. në Prishtinë, punëtor-axhystator i punësuar në OPB "Elektroekonomia e Kosovës", me vendbanim të përhershëm në Prishtinë, rruga e Splitit nr. 20;

9. BAHTIR Adem AHMETIT, lind më 30. o1. 1956 në Gumnasellë, KK Lipjan, me vendbanim të përhershëm në vendlindje, student i Fakultetit juridik;

10. NUSRET Adem AHMETIT, lind më 25. o1. 1959 në Gumnasellë, KK Lipjan, student i Fakultetit juridik në Prishtinë, me vendbanim të përhershëm në Prishtinë, rruga Robert Gajdiku nr. 60;

11. KADRI Sheqë CAKIÇIT, lind më 30. o4. 1957. në Prishtinë, punëtor i OP "Kosova" në Vuçitërnë, me vendbanim të përhershëm në Prishtinë, rruga Robert Gajdiku nr. 60;

12. ADEM Brahim DERVISHOLLI, lind në Vragoli, KK Prishtinë, student me korrespodencë i FAkultetit ekonomik, me vendbanim të përhershëm në Prishtinë, "Taslixhe I" nr. 52;

13. AGIM Sejdi AHMETIT, lind më 7. o1. 1956. në Prishtinë, jurist i diplomuar i punësuar në Shkollën fillore "Branisllav Nushiq" në Prishtinë, me vendbanim të përhershëm në Prishtinë, rruga e Bledit nr. 16;

14. AVDI Brahim KRASNIQIT, lind më 11. o3. 1960 në Koshutman, KK Pejë, student i SHLP në Prishtinë, me vendbanim të përhershëm në Pejë, rruga Boro Vukmiroviq nr. 88; dhe

15. MERIMAN Jakup BRAHA, lind më 27. 11. 1946. në Prizren, profesor i Shkollës bujqësore në Prishtinë, me vendbanim të përhershëm në Prishtinë, rruga e Leninit p.n.

S E P S E

Ekziston dyshimi i bazuar se kanë kryer vepra penale të drejtuara në rrëximin e pushtetit të klasës punëtore e të punonjëse, minimin e rregullimit shoqëro-ro ekonomik të përcaktuar me Kushtetutë, fyrjen e vëllazrim bashkimit,prishjen e barazisë së kombeve dhe kombësive dhe të ndryshimit antikushtetues të rregu-llimit Federativ të RSFJ, ashtu që pas shumë konsultimeve dhe komentimeve verbale në të cilat kanë shprehë mosknaqësinë me sistemin shoqëroro-politik e posaqërisht me pozitën e KSAK e cila sipas mendimit të tyre i ka "plotësuar" të gjitha kushtet për shpalljen e saj në "Republikë", me çka sipas mendimit të tyre do të eliminohen të gjitha dobësitë në zhvillimin ekonomik të sajë.

Si pjellë e një aktiviteti të tillë në verë të vitit 1978 vjen deri te takimi të cilin e kanë pregatitur Abdullah Prapashtica dhe Osman Osmani e që është mbajtur në shtëpinë e Abdullahut në Prishtinë, në rrugen e Bihaqit nr. 28-a në të cilin kanë marrur pjesë:

- Abdullah Prapshtica,
- Osman Osmani,
- Rexhep Maqedonci,
- Adem Prapshtica,
- Nusret Ahmeti,
- Adem Dervisholli,
- Kadri Cakiqi,
- Skënder Ibishi,
- Faton Topalli, dhe
- Lutfi Maqedonci (i cili e ka ruajtur rojen)

Ky takim ka qenë takim themelues i "Partisë komuniste marksiste-leniniste shqiptare në Jugosllavi". Takimin e ka hapur Adem Prapashtica, kurse e ka udhëhequr Abdullahu i cili të pranishmit i ka informuar për formimin e "Partis në fjalë, dhe për qëllimet e saja, kurse në fund është lexuar "Platforma ideol gjike e saj", e cila ka qenë e pregatitur qysh më parë. Pas diskutimeve dhe aprovimit të kësaj platforme,të gjithë kanë marrë për detyrë që të njejten ta përshkruajnë me qëllim që ta propagojnë dhe ta masovizojnë "Partinë" me bashkë mendimtarët e rinj.

Në fund të takimit e me qëllim që të sigurohet konspiracioni i duhur në aktivitetin e tyre ilegal armiqësor, të pranishmëve i janë caktuar pseudonimet, me të cilët do të shërbehen në komunikimin e mëtejmë, kështu Abdullah Prapashtica e merr pseudonimin "Duki", Rexhep Maqedonci "Kondor", Osman Osmani, "Osa", Adem Prapashtica, "Içeti", Nusret Ahmeti "Neka", Kadri Cakiçi, "Kulla", Faton Topalli" "Toni" etj.

Si produkt i një aktivitetit të thellë armiqësor e duke mos u kënaqur me metodat e veprimit verbal, pjesëtarët e "PKMLSHJ" të udhëhequr nga Abdullah Prapashtica, Rexhep Maqedonci përpilojnë të ashtuquajturen "Informatë" në tetë faqe të cilën ia dedikojnë Kryesisë të Komitetit të LK KSAK dhe Kryetarit të RSFJ, shokut Tito. Këtë informatë e dërgojnë më 1. o3. 1979, kurse më vonë më 3o. o5.1979 përsëri e pregatisin informaten në 7 faqe me titull "Për situaten politiko-ekonomike", të cilen ia dedikojnë organizatave politiko-shoqërore shqiptare në Jugosllavi - popullit she klasës punëtore në Jugosllavi. Që të dya këto informata janë me përmbajtje të thellë armiqësore dhe të drejtuara kunder sistemit tonë shoqëroro-politik. Në to informohen shkrukturat shoqëroro-politik për ekzistimin e "PKMLSHJ" dhe për qëllimet e saja duke i potencuar kërkesat e tyre siç janë:

- bashkimi i krahinave shqiptare në RSFJ;
- pavarsia territoriale nga Sërbia, Maili i Zi dhe Maqedonia;
- pavarsia politiko-ekonomike nga republikat tjera; dhe
- formimi i "Republikës socialiste shqiptare në Jugosllavi" etj.

Këto informata pos organizatave shoqëroro-politike të cilave iu janë dërguar di janë hudhur në oborre dhe te disa qytetar në Prishtinë.

Me 5. o5. 1980, pas vdekjes së Kryetarit Tito, në emër të "PKMLSHJ" dërgohet "Telegrami ngushllues", KQ të LKJ, të cilin e nënshkruajnë si "Prezidiumi i KQ të PKMLSHJ".

Në emër të "PKMLSHJ" është shtypur dhe dërguar strukturave materiali i shkruaj tur me titull "Projekti i materialit" në formë të broshurës në 150 faqe të formatit A-5, në të cilin veçohen titujt siç janë "PKMLSHJ" - avangardë e klasës punëtore dhe e popullit shqiptar në Jugosllavi", "Kur lindi PKSH", "Teritori, ekonomia dhe politika shqiptare në Jugosllavi","Materiali nga Konferenca e parë themeluese e PKMLSHJ", kurse si pjesë integrale të sajë janë "Statuti dhe instrukcionet partiake",kurse në fund dekreti me nëntitull:

"Jap urdhër që brenda vitit 1981. të kryhen këto detyra programore..." Dekreti është i nënshkruaj nga "Kryetari i KQ të PKMLSHJ në RSFJ".

Me 11. o3. 1980 në adresë të disa funkcionerëve të KSAK janë dërguar "Letra interne" dhe "Nota".

Të gjitha materialet e dërguara janë të nënshkruara në emër të forumeve të ndryshme të kësaj "Parite", si "Prezidiumi", "Komisioni për çështje nacionale", "Komisioni për informata", "Komiteti i ORKSHMLJ" etj. me çka është deshiruar që Partia të prezentohet si organizatë sa më masovike.

Shpërthimin e demostratave armiqësore kontararevolucionare me 26. o3.1981. në Prishtinë, anëtarët e kësaj "Partie" e shfrytëzojnë për plasimin e platformës së tyre politike, kështu që Abdullah Prapashtica e dërgon vëllaun Adem Prapashticen dhe Osman Osmanin që të ndikojnë në demostrantë, që demostrantëve t'iu napin kahje tjetër nga kërkesat sociale duke insistuar në mesin e demostra tëve që të përdoret parulla "Kosova Republikë", gjë që edhe kanë patur sukses, kështu që pas paraqitjes së tyre kjo parullë ka qenë domenante gjatë tërë demostratave armiqësore edhe më vonë.

Aktiviteti armiqësor i tyre veçanarisht është ardhur në shprehje në demostratat e 1 dhe 2 prillit të vitit 1981. Në të vërtet, pjesëtarët e "PKMLSHJ" në afishet e mëvonshme e marrin përgjegjësinë e organizimit të tyre e si deshmi në këtë drejtim fletë fakti se Abdullahu qysh më 28/29. o3. 1981. duke i shfrytëzuar lidhjet e veta familjare i jep Adem Prapasticës dhe FAhrije Osmanit tekstin me programin e parullave e këta i pregatisin 30 afishe po me këtë tekst të cilat i shpërndajnë në mesin e demostruesëve me 1. o4. 1981. Duhet përmendur se Admei, Fahrija, Osman Osmani dhe Avdi Krasniqi pos që i kanë shpërnda këto afishe para KK të LK në asfallët i kanë shkruajtur edhe parulla të ndryshme armiqësore siç janë: "Kosova republikë", "Adem Demaçi hero" etj.

Pas demostratave kontararevolucionare pjesëtarët e "PKMLSHJ" të inkurajuar me "sukseset" e aktivitetit armiqësore veprimtarinë e vet ilegale armiqësore e vazhdojnë në mënyrë edhe më intenzive e si fryt i kësaj pune është pregatitja, shtypja dhe shumëzimi i fletushkës "Teoria dhe praktika e revolucionit", "Revolucioni" dhe "Zëri i atdheut", në të cilat në mënyrë të paskupurt sulmohet sistemi i ynë shoqëroro-politik, kurse "PKMLSHJ" paraqitet si organ i cili i mbron interesat e popullit dhe klasës punëtore të shqiptarëve në Jugosllavi. Vrazhdësia e tyre shifet edhe në fletushkën "Zëri i atdheut"

ku në kopertinen e saj është vizatuar "Stema e Republikës Socialiste Shqiptare në Jugosllavi", me dt. 2. o4. 1981. pra dita kur demostrantat kontarrevolucionare në Prishtinë, kanë qenë më masovike dhe kur janë bërë dëmet e mëdha materiale dhe njerëzore.

Me 5. o6. 1981., nga "Partia" i dërgohet letra Kryeredaktorit të së përditshmës "Borba" në Beograd, letra KQ të LKJ, afishi në formë të letres i cili iu është drejturar pjesëtarëve të kombësisë sërbe dhe malazeze si dhe afishi i drejtuar pionerëve.

Në periudhen pas demostratave gjatë verës 1981. në shumicen e materialeve të shkruara armiqësore ka marrëpjesë e sidomos në korigjimin e tyre që janë shkruajtur pas demostratave kontrarevolucionare Meriman Braha, të cilin e kanë strehuar vet Abdullah Prapashtica dhe Rexhep Maqedonci, dhe e kanë dërguar në një shtëpi të vetmuar në Ferizaj. Kohen e kaluar në strehim Merimani e ka sjfrytëzuar për të zhvilluar veprimtari armiqësore në pregatitjen e materialeve tëpërmendura. Ai posaqërisht është angazhuar për pregatitjen e demostratave nëtë cilat do të mirrnin pjesë gratë, e me qëllim që të bëhet presion që të lirohen "burrat dhe vëllazrit e tyre" të denuar politik. Për këtë qëllim pregatisin "Programin" për të shpërnda afishe.

Me qëllim të masovizimit të "PKMLSHJ" në ndërkohë për veprimtari armiqësore janë angazhuar persona të rinj siç janë: Bahtir Ahmeti, Agim Ahmeti, Osman Maqedonci, Fatmir Grajçevci, Martin Çuni dhe Arben Hoxha, të cilët pasi që jan informuar për ekzistimin e "PKMLSHJ" kanë lexuar materialet e ndryshme me përmbajtje armiqësore të kësaj "Partie", janë udhëzuar për aktivitetin e mëtejmë armiqësor dhe kanë marrë detyra konkrete për vazhdimin e veprimtarisë ilegale armiqësore.

Me rastin e bastisjes së shtëpisë së Abdullahut dhe Adem Prapashticës me 7. o4 1982 janë gjetur në origjinal materialet:

- "Zëri i atdheut" (në dorëshkrim)
- "Platforma politike e PKMLSHJ" (në dorëshkrim),
- letra në dorëshkrim e dërguar nga "Organizata e rinisë komuniste shqiptare"në Ferizaj,
- origjinali i letres dërguar Kryeredaktorit të"Borbes" nga PKMLSHJ,
- origjinali i letrës "Letër Komitetit Qendror të LK të Jugosllavisë",
- pamfleti origjinal "Nisiti gueril i pionerëve shqiptar"
- letra AKMLPJ,
- fletushkat "Revolucioni", "Teoria dhe praktika e revolucionit" dhe

- projekti i materialit në 150 faqe,
- një kuti indigo,
- një makinë e shkrimit "Olimpia" monika, dhe
- një heft makinë për kapjen e fletëve.

Në bazë të të dhënurave të lartëpërmendura, kjart shifet se të përmendurit kanë kryer vepër penale të bashkimit për veprimtari armiqësore nga neni 136. alinea 1. lidhur me nenin 114 të LPF, andaj propozojmë që ndaj tyre të hapet procedura penale, të caktohet paraburgimi, kurse disa veprime hetimore t'i besohen këtij Drejtorati.

Provat:

Deklaratat e:
Rexhep Maqedoncit, Adem Prapashticës, Lutfi Maqedoncit, Martin Çunit, Arban Hoxhës, Osman Maqedoncit, Bahtir Ahmetit, Nusret Ahmetit, Avdi Krasniqit, Kadri Cakiçit dhe Adem Dervishollit.

- fotokopja e informatave të dërguara me 1. o3. 1979 dhe me 3o. o5. 1979.
- afishi "Pismo",
- letra dërguar Kryeredaktorit të "Borbes" me 5. o6. 1981.
- afishi "Nisiti gueril i pionerëve shqiptar",
- afishi letër të KQ të LKJ,
- letra KQ të PKMLSHJ,
- fletushka "Zëri i atdheut", "Teoria dhe praktika e revolucionit" dhe "Revolucioni",
- punimi "Projekti i materialit",
- procesverbali i bastisjes së banesës së ADem Prapashticës,
- fotodokumentacioni nr. 387 i dt. 7.o4.1982,
- mendimi i ekspertit për dorëshkrim,
- fotokopja e "Telegramit", dërguar nga PKMLSHJ,
- materialet "Netët dhe hijet" dhe
- "Uji nën urë nuk ndalet".

FN/IO

KRYESHEFI I DSHSSH PRISHTINË,
Mehmet Lumi

* * *

AKTVENDIMI HEP.NR.91/82

Hap.nr. 91/82

Gjyqtari hetues i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, në çështjen penale kundër Rexhep Maçedoncit, Osman Osmanit, Adem Prapashticës, Fatmir Grajçevcit, Lutfi Maçedoncit, Martin Çunit, Arban Hoxhës, Osmen Maçedoncit, Bahtir Ahmetit, Nysret Ahmetit, Kadri Cakiqit, Adem Dërvishollit, Agim Ahmetit, Avdi Krasniqit dhe Meriman Brahës për shkak të veprës penale nga neni 136 al. 1 lidhur me nenin 114 të LP të RSFJ dhe 136 al. 2 lidhur me nenin 114 të LPJ, në bazë të nenit 191 al. 2 pika 2 e 4 ~~të LPK~~ dhe nenit 192 të LPP, mori këtë

A K T V E N D I M

Kundër:

1. REXHEP MAÇEDONCIT nga i ati Nazifi i lindur më 3 mars 1956 në Prishtinë, apsolvent i Fakultetit juridik, ish milicioner, i punësuar në SPB në Prizren, me vendbanim të përhershëm në Prishtinë,

2. OSMAN OSMANIT, nga i ati Zeneli, i lindur më 15 nëntor 1957 në Prishtinë, student i Fakultetit juridik, me vendbanim të përhershëm në Prishtinë rr. Iskrës nr. 26, tani gjendet në arrati,

3. ADEM PRAPASHTICËS, nga i ati Zeqir, i lindur më 20.05.1957 në Prishtinë, me vendbanim të përhershëm në Prishtinë rruga e Bihaqit nr. 28-a,

4. FATMIR GRAJÇEVCIT, nga i ati Zenel i lindur më 25.03.1963 në Prishtinë, student i vitit të parë të Fakultetit teknik, me vendbanim të përhershëm në Prishtinë, rruga Svetozar Markovic nr. 40/a,

5. LUTFI MAÇEDONCIT, nga i ati Nazif i lindur më 4.02.1962 në Prishtinë, student i Fakultetit teknik, me vendbanim të përhershëm në Prishtinë, rruga e Splitit nr. 20,

6. MARTIN ÇUNIT, nga i ati Ndrec, i lindur më 14.05.1948, në fshatin Ujz, gazetar i Radio-Prishtinës, me vendbanim të përhershëm në Prishtinë, rruga e Bihaqit nr. 20,

7. ARBAN HOXHËS, nga i ati Mehmet i lindur më 1.09.1963 në Prishtinë, nxënës i QAMO "9 Maj" në Prishtinë, me vendbanim të përhershëm në Prishtinë, rruga A.Gjorgjevic, nr. 11,

./.

8. OSMAN MAQEDONCIT, nga i ati Nazif, i lindur më 2.05.1952, në Prishtinë, punëtor-arkyetator i punësuar në OPB "Elektroekonomia e Kosovës", me vendbanim të përhershëm në Prishtinë, rruga e Ballit nr. 20,

9. BAHTIR AHMETIT, nga i ati Adem, i lindur më 30.01.1965 në Gumnasellë, KK Lipjan, me vendbanim të përhershëm në vendlindje, student i Fakultetit juridik,

10. NYSRET AHMETIT, nga i ati Adem, i lindur më 25.01.1959 në Gumnasellë, KK - Lipjan, student i Fakuletetit juridik, në Prishtinë, me vendbanim të përhershëm në Prishtinë, rruga Robert Gajdiku nr. 60,

11. KADRI CAKIQIT, nga i ati Sheqë, i lindur më 30.04.1957 në Prishtinë, punëtor i OP "Kosova" në Vuçitërnë, me vendbanim të përhershëm në Prishtinë, rruga Robert Gajdiku nr. 60,

12.ADEM DERVISHOLLI, nga i ati Brahim, i lindur më 7.02.1957 në Vragoli KK Prishtinë, student me korespondencë në Fakultetin ekonomik, me vendbanim të përhershëm në Prishtinë, "Taslixhe I" nr. 52,

13. AGIM AHMETI, nga i ati Sejdi, i lindur më 7.01.1956 në Prishtinë, jurist i diplomuar, i punësuar në Shkollën fillore "Branislav Nushiq" në Prishtinë, me vendbanim të përhershëm në Prishtinë, rruga Ke Bledit nr. 16,

14. AVDI KRASNIQI, nga i ati Brahim, i lindur më 11.03.1960 në Koshutman KK Pejë, student i SHLP në Prishtinë, me vendbanim të përhershëm në Pejë, rruga Boro Vukmirovic nr. 88 dhe

15. MERIMAN BRAHA, nga i ati Jakup, i lindur më 27.XI.1946 në Prizren, profesor i Shkollës bujqësore në Prishtinë, me vendbanim të përhershëm në Prishtinë, rruga Leninit p.nr.

CAKTOHET PARABURGIMI

Për shkak të veprës penale nga neni 136 al. 1 lidhur me nenin 114 të LP të RSFJ dhe 136 al. 2 lidhur me nenin 114 të LPJ.

Paraburgimi u llogaritet prej datës 13 maj 1982, ndërsa Osman Osmanit prej datës kur privohet nga liria.

./.

A r s y e t i m i

Ekziston dyshimi i bazuar se Rexhep Maqedonci, Osman Osmani, Adem Prapashtica, Lutfi Maqedonci, Nysret Ahmeti, Kadri Cakici, dhe Adem Dërvisholli kanë kryer veprën penale bashkimi për veprimtari armiqësore nga neni 136 al. 1 lidhur me nenin 114 të LP të RSFJ, ndërsa Meriman Braha, Bahtir Ahmeti, Agim Ahmeti, Osman Maqedonci, Avdi Krasnici, Martin Çuni, Fatmir Grajçevci dhe Arban Poxha veprën penale bashkimi për veprimtari armiqësore nga neni 136 al. 2 lidhur me nenin 114 të LP të RSFJ.

Paraburgimi caktohet në bazë të nenit 191 al. 2 pika 2 e 4 të LPP.

GJYKATA E QARKUT NË PRISHTINË,
më dt. 13 maj 1982 v.

GJYQTARI PETUES,
Isak Nisheyci

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij të pandehurt kanë të drejtë ankese Kolegjit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë në afat prej 24 orësh prej kohës së marrjes së kopjes së këtij aktvendimi. Ankesa nuk e ndalon ekzekutimin e aktvendimit.

****

© Pashtriku.org, Mars'2014